

## **Dekan Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban**

Prof. Dr. Sherif Lushaj



Prof. Dr. Sherif Lushaj është diplomuar ne Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit Bujqësor, Tiranë. I specializuar në fushën e Shkencës së Tokës, mban titujt shkencorë “Profesor”, “Profesor Asoc”, “Docent” dhe gradat shkencore “Doktor i shkencave” (vendim nr. 280, date 9.06.1992), “Doktor i Shkencave” (VKM nr. 351, datë 10.07.1995), “Kandidat i Shkencave” (vendim nr. 35, date 31.01.1981). Eksperienca e tij e punësimit është fokusuar në kërkim shkencor dhe mësimdhënie: Instituti i Kërkimeve Bujqesore Lushnjë (shef i sektorit te kimisë së tokës dhe pedologjisë), Instituti i Tokave Tiranë (Drejtor). Për 10 vjet ka qenë pedagog me kohë të pjesshme në Fakultetin e Bujqësisë në lëndën e Agrokimisë dhe Pedologjisë. Ka qenë anëtar i Senatit të UB në 2 mandate (1999-2007), udhëheqës studentesh për diplomën e shkollës së larte, pasuniversitare, për Grada Shkencore dhe anëtar i jurive për mbrojtjen e gradave shkencore në me shumë se 150. Në fushën e shkencës së tokës dhe mjedisit ka realizuar 200 studime dhe projekte shkencore, 210 publikime shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe 190 prezantime në koferenca dhe workshope brenda dhe jashtë vendit. Ai është autor dhe bashkëautor i shumë studimeve kombëtare dhe drejtues i 12 projekteve bilaterale të bashkëpunimit shkencor me BE, Shqipëri-Itali, Shqipëri-Greqi etj. Gjithashtu, është anëtar i disa organizatave ndërkombëtare. Nga viti 2012 punon si profesor në Universitetin POLIS duke zhvilluar lëndë dhe module në programin Studime Mjedisore, Planifikim dhe në nivelin master Menaxhim Mjedisor Urban. Gjithashtu, është dekan i Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban i po të njëjtit universitet.